

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Shqipe Qerimi, kryetar i kolegjit, Afrim Shala dhe Dalip Bega, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Kimete Veseli, si procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të akuzuarit H.B., nga fshati ..., Komuna e Skenderajt, për shkak të veprës penale mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare, nga neni 437 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, PP.II.nr.690/2017, të datës 10 maj 2018, të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj, P.nr.119/2017, i datës 23 prill 2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 28 gusht 2018, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj, P.nr.119/2017, i datës 23 prill 2018, VËRTETOHET.

## A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj, me aktgjykimin e lartcekur, të akuzuarin H.B., në bazë të nenit 364 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.3. të Kodit të Procedurës Penale (KPP) e ka liruar nga akuza për shkak të veprës penale mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare, nga neni 437 paragrafi 1 të KPRK.

Shpenzimet e procedurës penale është vendosur që të paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë Prokuroria Themelore në Mitrovicë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës, që aktgjykimin e

ankimuar ta anuloj dhe kjo çështje penale t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë rigjykim dhe vendim.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtresën PPA/II.nr.611/2018, të datës 17 korrik 2018, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, ndërsa çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, analizoj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të KPP, konstatoj se :

- ankesa është e pabazuar.

Në ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë theksohet se me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë janë bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga se arsyet të paraqitura janë të paqarta, në masë të konsiderueshme kontradiktore, si dhe ekzistojnë kontradikta në mes të fakteve vendimtare. Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetim të gabuar të gjendjes faktike sa i përket veprës penale të përshkruar në dispozitivin e aktakuzës, nga se nuk janë marr për bazë provat që gjenden në shkresat e lëndës. Nga dëshmia e dëshmitares V.Z.-Zyrtare e lartë për mbikëqyrjen e pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit (AKK) vërtetohet se i akuzuari është kryerës i veprës penale për të cilën është akuzuar. Dëshmitarja thekson se i akuzuari formularin e deklaramit e pasurisë në AKK e ka dorëzuar me datën 5 prill 2017 pas kalimit afatit zyrtar i cili ishte me datën 31 mars 2017. Dëshmitarja kishte theksuar se Zyrtari i lartë publik formularin e deklaramit e pasurisë në AKK mund ta bëjë vet ose përmes personit tjetër. Ndërsa, personi kontaktues nuk është i detyruar që t'i dorëzoj formularët për deklaramin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik në AKK, por nëse dëshiron, një gjë të tillë mund të bëjë në mënyrë vullnetare. Prokuroria Themelore në Mitrovicë në ankesën e paraqitur i referohet edhe provave materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, siç janë : njoftimet e AKK-së, të datave 01 mars 2017, 17 mars 2017 dhe 27 mars 2017, nga të cilat vërtetohet se janë bërë njoftime publike përmes të cilave janë njoftuar zyrtarët e lartë publik lidhur me detyrimin e tyre për deklaramin e pasurisë. Po ashtu, në ankesë u janë referuar edhe shkresës elektronike të zyrtarit kontaktues A.G. dhe vet formularit të deklaramit të pasurisë të akuzuarit H.B., me pretendimin se gjykata e shkallës së parë nuk e kishte marrë për bazë këto prova nga të cilat do të vërtetohej fajësia e të akuzuarit H.B.. Gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së aktgjykimit lirues pothuajse në tërësi i kishte marrë për bazë vetëm alibinë e të akuzuarit, si dëshmitë e dëshmitarëve A.G. dhe Sh.M.. Duke u bazuar në të gjitha këto që u tha më lartë, Prokuroria Themelore në Mitrovicë i propozon Gjykatës e Apelit të Kosovës që aktgjykimin e ankimuar ta anuloj dhe kjo çështje t'i kthehet gjykatës shkallës së parë në rigjykim dhe vendim.

Sipas vlerësimit e Gjykatës të Apelit të Kosovës, pretendimet e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale

nuk qëndrojnë. Aktgjykimi i gjykatës shkallës së parë nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, arsyet e paraqitura janë të qarta dhe bindëse në njërin anë, kurse në anën tjetër në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar janë të paraqitur në mënyrë mjaftueshme arsyet lidhur me faktet vendimtare në këtë çështje penale të cilat do të elaborohen në vijim. Përveç këtyre shkeljeve të pretenduara, Gjykata e Apelit të Kosovës konstaton se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban as shkelje të tjera të dispozitave të procedurës penale për të cilat kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, konform nenit 394 paragrafi 1 të KPP.

Edhe pretendimi ankimor për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës është i pabazuar. Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike në këtë çështje penale dhe një gjendje të tillë faktike, gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar pas administrimit të një mori provave gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor. Në këtë drejtim, gjendja faktike në këtë çështje penale është vërtetuar pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha provave që janë administruar nga gjykata e shkallës së parë, vlerësimi i të cilave është bërë një nga një dhe duke i ndërlidhur në mënyrë reciproke njëra me tjetrën. Provat mbi bazën e të cilave është vërtetuar gjendja faktike nga ana e gjykatës së shkallës së parë janë: deklarimi i të akuzuarit H.B., deklarimi i dëshmitarëve V.Z., A.G. dhe Sh.M., si dhe nga provat materiale, siç janë shkresat e AKK me numër të rastit AK-02-1429/2017, listën e zyrtarëve publik të Komunës të Skenderajt, të datës 14 shkurt 2017, Njoftimit publik të AKK të datës 28 shkurt 2017, Njoftimit të AKK të datës 1 mars 2017, Njoftimeve elektronike të AKK të datave 17 dhe 27 mars 2017, shkresës elektronike të zyrtarit A.G., formularit të deklarimit të pasurisë të të akuzuarit H.B. dhe kërkesës të AKK për sqarim e datës 9 qershor 2017. Nga të gjitha këto prova të cilat janë administruar dhe vlerësuar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, gjykata e shkallës së parë drejtë kishte vepruar kur të akuzuarin H.B. e kishte liruar nga akuza, ngase nuk është provuar se i njëjti e kishte kryer veprën penale për të cilën është akuzuar. Gjykata e Apelit të Kosovës e vlerëson si të drejtë konstatimin e gjykatës shkallës së parë se në rastin konkret nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, ngase nga provat e administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, në veçanti të dëshmitarëve A.G. dhe Sh.M. është vërtetuar se i akuzuari formularin për deklarimin e rregullt e pasurisë e kishte bërë me datën 24 mars 2017 dhe të njëjtin e ka dorëzuar në Zyrën e shefit të kryetarit të Komunës së Skenderajt në mënyrë që i njëjti më pastaj këtë formular ta dërgoj të zyrtari kontaktues për ta përcjell më pastaj këtë formular në mënyrë elektrike në AKK. Mirëpo, formulari për deklarimin e pasurisë nuk është dorëzuar në AKK për shkak të harresës kolegut të të akuzuarit. Në kuadër të një gjendje të tillë faktike të vërtetuar është konstatuar me të drejtë se nuk janë përmbushur elementet e veprës penale për të cilën është akuzuar i akuzuari H.B., ngase duke u bazuar në nenin 437 paragrafi 1 të KPRK kjo vepër penale për të cilën është akuzuari i akuzuari mund të kryer vetëm me dashje, si formë të fajësie kurse në anën tjetër një gjë e tillë nuk është vërtetuar tek i akuzuari. Në rastin konkret i akuzuari kishte manifestuar vullnetin për ta deklaruar pasurinë në AKK, por për arsye të cilat nuk janë varura nga ai-harresa e kolegut të tij, ky formular nuk ka arritur që brenda afatit ligjor të dorëzohet në AKK, por nga shkresat e lëndës shihet

që ky formular është dorëzuar me datën 5 prill 2017. Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, Gjykata e Apelit e Kosovës konstaton se gjendja faktike në këtë çështje penale është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, si dhe konkludimet e gjykatës e shkallës së parë lidhur me faktet vendimtare janë të drejta, të arsyeshme dhe të ligjshme. Si rezultat e kësaj gjendje faktike të vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, Gjykata e Apelit e Kosovës konstaton gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë as shkelje të ligjit penal në favor të akuzuarit, siç pretendohet në ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë. Andaj, duke u bazuar në të gjitha këto që u cekën më lartë, Gjykata e Apelit e Kosovës vendosi që ta refuzojë si të pabazuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë.

Duke u bazuar në këto që u tha më lartë e në bazë të nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
Departamenti i Përgjithshëm  
PA1.nr.604/18, Më 28 gusht 2018

Bashkëpunëtoreshë profesionale,

Kimete Veseli

Anëtarët e kolegjit:

1. Afrim Shala

2. Dalip Bega

Kryetare e kolegjit,

Shqipe Qerimi